



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.520/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Safet Voca, Shefi i Sektorit ligjor të degës në Mitrovicë, nga subjekti politik PDK, me seli në Mitrovicë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër komisionerit në Vendvotimin VV nr.13, me seli në Mitrovicë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Safet Voca, Shef i Sektorit ligjor të degës në Mitrovicë, nga subjekti politik PDK, me seli në Mitrovicë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.520/2017, të datës 25.10.2017, e parashtruar kundër komisionerit në Vendvotimin VV nr.13 me seli në Mitrovicë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë përmes dërgesës postare, e njëjta e protokolluar me datë 25.10.2017 nga Safet Voca, në cilësinë e Shefit të Sektorit ligjor të degës në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Mitrovicë, me të cilën thekson se me datën 22.10.2017 në Ditën e Votimit në shkollën fillore “Avdullah Shabani”, në vendvotimin nr.13, në Mitrovicë, një komisionerë me iniciativën e vetë me rastin e votimit e ka penguar Fatime Tabakun që të votoj, pa asnjë arsye, prandaj nga të lartëcekurat me këtë rast është bërë shkelje e nenit 89 paragrafi 2 i LZP-së.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës Safet Voca, në cilësinë e Shefit të Sektorit Ligjor të degës në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Mitrovicë, lidhur me shkeljen e pretenduar lidhur me parregullsitë në ditën e zgjedhjeve, Paneli i vlerësoj si të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se pretendimet ankimore të ankuesit sipas ankesës nuk janë të provuara me asnjë provë bindëse dhe nuk e ka specifikuar shkelësin e supozuar, pasi që barra e të provuarit i përket ankuesit sipas nenit 5.3 pika (c) dhe (e) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Rregullës nr. 02/2015), me qëllim të vërtetimit të shkeljes së

supozuar, e këto prova nuk i janë të bashkangjitura në ankesë, Paneli vendosi që ankesën e ankuesit ta refuzoj.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.520/2017 më datën 25.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.